



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail.. contact@pallatirinise.com
www.pallatirinise.com

Në bazë të vendimit të miratuar me datën 21.06.2021 nga ana e Menaxhmentit të NPL PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë, e duke u bazuar në nenin nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, nenit 4 pika 1,2,3,4,5, nenit 5 të udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 6 të Rregullores së Punës, N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. – Prishtinë, U.d. Kryeshefi Ekzekutiv me datë 26.06.2021, **SHPALLË:**

KONKURSIN PUBLIK

I. Titulli i vendit të punës: punëtor fizik të mirëmbajtjes higjienike në njësinë e ndërtimtarisë dhe mirëmbajtjes higjienike në Departamentin tekniko - higjienik (**4 punëtorë**);

II. Numri i referencës: NPL –D.T. 26/06/21:

III. Detyrat dhe përgjegjësitë:

Organizon, mbikëqyrë dhe përgjigjet për mirëmbajtjen e punëve dhe detyrave të punës e sidomos këtyre punëve:
-kryen të gjitha punët fizike në nivel të, NPL "PALLATI I RINISË" SH.A. në Prishtinë
-bënë bartjen e panove për programe të ndryshme në qendër dhe në qytet,
-sjelljen dhe largimin e sendeve të ndryshme dhe të inventarit nga lokalet e NPL "PALLATI I RINISË" SH.A. në Prishtinë ,
-bartjen, montimin dhe demontimin e ringut, tribunave, skelave të ndryshme hedhjen e mbeturinave,
-pastrimin dhe mirëmbajtjen e lokaleve dhe hapësirave në objekt, lokalet e punës në qendër dhe në të gjitha sipërfaqet tjera, pastrimin e mureve, karrigeve, tavolinave dhe enterierit tjetër,
-mirëmban pastërtinë e dyshemesë, tepihëve, larjen e dritareve, perdeve e tjera,
-bënë pastrimin me mjete teknike të gjitha sipërfaqeve që mund të pastrohen në qendër e edhe me makinë thithëse, dhe u ndihmon punëtorëve tjerë në Departamentin e vet dhe në Departamente tjera lidhur me pastërtinë,
- kryen edhe punë tjera me urdhëresën e para punëtorit, kryepunëtorit dhe udhëheqësit të njësisë – përgjegjësit të ndërtimtarisë dhe dhe mirëmbajtjes higjienike.

IV. Kushtet për pjesëmarrje në procesin e rekrutimit

- Kërkesa për punësim (aplikacioni);
- Dëshmi për shkollimin e noterizuar;
- Certifikata nga Gjykata Themelore në Prishtinë se nuk gjenden nën hetime apo për vepra të tjera.
- Certifikata e mjekut,
- Certifikata e Lindjes,
- Kopja e letërnjoftimit;
- Adresa e vendbanimit;
- Nr. i telefonit kontaktues si dhe
- E-maili kontaktues;

V. Kualifikimet e nevojshme arsimore, aftësitë specifike dhe përvoja e punës

- Diploma e noterizuar e kualifikimit fillor,
- Një (1) vjet përvojë pune në vendin e punës,
- Etikë profesionale dhe të jetë në gjendje të punoj nën presion;

VI. Kohëzgjatja e emërimit:

- Kontratë në kohë të caktuar si punë provuese prej 6 (gjashtë) muajve me mundësi vazhdimi.

VII. Data e mbylljes së konkursit:

- Konkursi është i hapur në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarik dhe atë nga data e publikimit.

VIII. Mënyra se si merret dhe si dorëzohet formulari i aplikacionit për punësim:

- Aplikacionet për punësim mund të merren fizikisht në zyrën e Departamentit të Administrimit Qendror dhe të njëjtat do të dorëzohen në arshivën e N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë si dhe mund të shkarkohet në web-faqën zyrtare/ www.pallatirinise.com si dhe në facebook-un zyrtar/Pallati i Rinisë, duke klikuar paraprakisht/ like.

IX. Afati i dorëzimit të aplikacioneve për punësim:

- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.